

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SPAK zbardh kërkesën: Shefja e SHISH do të merret në pyetje mesditën e nesërme, dy të tjerët në orën 9 të mëngjesit (DETAJE)
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/spak-zbardh-kerkesen-shefja-e-shish-do-te-merret-ne-pyetje-e-mesditen-e-i401915
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:55:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 14:44:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4dd2b9a04b380e064263df9cf276af6ca3efaa39bd03ca89bdf5ee52dc4ea66
TEKSTI	ed541c47d1204d5e4f39fccf727690ccfc9bd3a6e10ff255681d1902cbc9cbe7
PAMJA	a05e1de33b7cec924611019f831d0e006756e6e7728944f80ace6bf4ee4e7d79

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	00a6c375a62ba4521dd7bfa348aa558cc31a944b4ed92568dbb69922936a3350
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/00a6c375a62ba4521dd7bfa348aa558cc31a944b4ed92568dbb69922936a3350>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista



Kreu

Politikë

Aktualitet

Ekonomi

Kulturë & Art

Rajon

Sport

Bota

Showbiz

SocialBomb



Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Aktualitet

23 Shtator 2026, 16:44

SPAK zbardh kërkesën: Shefja e SHISH do të merret në pyetje mesditën e nesërme, dy të tjerët në orën 9 të mëngjesit (DETAJE)



Shkruar nga Newsbomb



GJKKO, Vlora Hyseni, Ergys Agasi, Embro Sulejmani dhe Fatjon Kalluqi

Dy ditë pas mbërritjes së saj në Shqipëri, ku u shpall në kërkim nga SPAK pasi akuzohej për përkrahje të biznesmenit kontrovers Ergys Agasi, i cili prej kohësh ka qenë në kërkim nga drejtësia shqiptare për skandalin me AKSHI-n, shefja e SHISH, Vlora Hyseni mësohet se do të dalë para GJKKO.

Mësohet se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ditën e nesërme, në orën 09:00 do të marrë në pyetje personat nën hetim Fatjon Kalluqi dhe Embro Sulejmani, ndërsa seanca gjyqësore për Vlora Hysenin do të mbahet po nesër në orën, 12:00.



Revista



Abonohu tani dhe lexoje

Lajmet e fundit



Bota

Rusia godet qendrat e të dhënave në Kiev, ndërpritet interneti për 100 mijë familje



Politikë

"Shteti i gysrave" Sallianji "shpërthen" pas arrestimit të shefes së SHISH. Qeveria e Ramës ka ulur pantollonat para krimit (REAGIMI)

Zbulo më shumë artikuj



Siç dhe kemi raportuar këto dy ditë, për Vlera Hysenin janë caktuar masat e sigurisë “Arrest në shtëpi” dhe “Pezullim i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik”, si person nën hetim për veprat penale të parashikuara nga nenet 302/2 dhe 295/a/1 të Kodit Penal.

Nenet 302/2 dhe 295/a/1 të Kodit Penal bëjnë fjalë për Përkrahje të autorit të krimit, në këtë rast Ergys Agasi, në mënyrë që ai t'i shpëtojë kërkimit, kapjes ose arrestimit, si dhe Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete, dhënia e informacioneve të konsideruara sekret ndaj personave të tretë, sërisht në këtë rast Ergys Agasi.

Vlera Hyseni akuzohet për këto dy vepra penale dhe ndaj saj janë caktuar dy masat e sigurisë të mësipërme.

Një ditë para se Hyseni të njihet me masën e sigurisë, kanë dalë në pah një sërë bisedash të ndara mes saj dhe biznesmenit kontrovers Ergys Agasi, të cilët rezultojnë se kanë pasur një komunikim periodik, të përditshëm dhe të tejzgjatur në kohë, përcjell [newsbomb.al](#).

Kështu rezultojnë në dosjen hetimore të Prokurorisë së Posaçme, në ngarkim të ish-kryespiunës së Shqipërisë, e cila tashmë është e akuzuar për dy vepra penale, si e dyshuar për zbulim të sekretit hetimor dhe pengimin e arrestimit të Ergys Agasit.

Këshilluar për ty



28 thirrje pa përgjigje dhe 25 të refuzuara, Ergys Agasi nuk i hapte telefonin Vlera Hysenit, SPAK zbardh bisedat në "Signal": Ka dhe telefonata me video

"Ashtu sikurse rezultojnë nga bisedat, shtetasi Ergys Agasi jo vetëm që nuk është në rolin e "bashkëpunëtorit", por në të kundërt është ai që merr dhe dikton informacionin e marrë", sqaron SPAK, pasi më herët Vlera Hyseni kishte pretenduar para hetuesve se me Gasin kishte vetëm marrëdhënie zyrtare, si bashkëpunëtor i SHISH.

Mirëpo, nga këqyrja e aparatit celular të biznesmenit, hetuesit kanë arritur të zbulojnë se Vlera Hyseni dhe Ergys Agasi kishin komunikim të përditshëm, edhe pasi ai u shpall në kërkim. Madje, jo vetëm telefonata të thjeshta, voice call, por edhe telefonata me video, video call, dhe dërgim e marrje fotosh e videosh.

"Në total, për periudhën 28.06.2026 deri më 26.08.2026, data e arrestimit të shtetasit Ergys Agasi, nëpërmjet aplikacionit "Signal", janë regjistruar në total thirrje voice and video call: thirrje hyrëse Vlera-Ergys, incoming call, 70 thirrje; thirrje dalëse Ergys-Vlera, outgoing call, 17; të humbura, missed call, 28; thirrje pa përgjigje, unanswered calls, Ergys nuk i përgjigjet Vlorës, 25; thirrje dhe thirrje të refuzuara, declined calls.

Në lidhje me komunikimet ndërmjet Ergys Agasit dhe Vlera Hysenit, të ruajtura në funksionin BIOME të aparatit telefonik të shtetasit Ergys Agasi janë të ruajtura gjithsej 508 forma komunikimi, calls, voice, video calls, messages, chat messages, ndërmjet këtyre dy shtetasve për periudhën e sipër-cituar, thotë SPAK.

Po ashtu, mbrëmjen e djeshme [newsbomb.al](#) solli në vëmendje një profil të detajuar të Vlera Hysenit, shëfese së njërës prej institucioneve më të rëndësishme në vend, e cila

perfundoi nën lupën e drejtësisë për perkrashje të Ergys Agasit dhe shpërndarjes së sekreteve shtetërore.

Këshilluar për ty



Profili i paautorizuar i kryespionës shqiptare, si mbërriti Viora Hyseni në krye të Shërbimit Informativ të Shtetit (Botuar në 2023 në Revistën Newsbomb)

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Mërkurë 20:27 Newsbomb

GJKKO e do në burg për trafikimin e dhjetërave ton kokainë, PRANGOSET në Rusi i shumëkërkuari Shpëtim Aliu, "shoku" i Eldi Dizdarit pritët t'i dorëzohet Shqipërisë (DETAJE)



Aktualitet

Kryeqyteti pret të dielën "Triathlon", në fundjavë do të ketë bllokime rrugësh, ja cilat zona do të "paralizohen"

🕒 E Mërkurë 19:54



Aktualitet

Aksident i dytë brenda ditës në Durrës, makina përplas qytetarin me skuter elektrik

🕒 E Mërkurë 19:14



Aktualitet





E Mërkurë 18:39 Newsbomb

Duraj tha se Bleona Mata është gjallë, nëna "e helmuar" nga deklarata e tij e paralajmëron: Do të ndjek penalisht! Reagon dhe SPAK



Aktualitet

KED lejon tre kandidatë të vazhdojë garën për Gjykatën Kushtetuese, ndalohet vetëm Brunilda Bara

E Mërkurë 17:52



Aktualitet

Parkimi në rrugët e Durrës bëhet me lekë, ja sa do të paguajnë qytetarët

E Mërkurë 17:45



E Mërkurë 17:35 Newsbomb

E RËNDË në Dibër, efektivi i Policisë ndalohet për dhunë fizike ndaj një vajze dhe vëllait të saj të mitur (DETAJE)



Aktualitet

Behgjet Pacolli publikon FOTO me dy miqtë e tij nga Nju Jorku, por puna që ata bëjnë mund ta ndihmojë shumë për Aeroportin e Vlorës

E Mërkurë 17:07



Aktualitet

Sërish zjarr në Vlorë, vatra e tretë për sot, rrezikohet spitali i qytetit dhe banesat, detajet e para

E Mërkurë 15:49 Newsbomb





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.